

Menu Kryesore

FAQE KRYESORE
 MISIONI
 MINISTRI
 FJALIME TE MINISTRIT
 ORGANIZIMI I MINISTRISE
 BUXHETI I MMPAU
 DEKLARIMI I PASURISE
 VENDE VAKANTE
 HARTA E FAQES
 KONTAKTE

Legjislacioni dhe Strategjite

STRATEGJI
 KONVENTA
 AKTE LIGJORE
 VENDIME TE KESHILLIT TE
 MINISTRAVE
 UDHEZIME
 RREGULLORE
 KENDI I BASHKIMIT EUROPIAN

Publikimet e Ministrise

NJOFTIMET
 RAPORTET E GJENDJES SE
 MJEDISIT
 BULETINI MJEDISOR
 SHERBIMET PER PUBLIKUN
 KALENDARI I DITEVE MJEDISORE
 DRAFTE PER KOMENTIM
 KOMENTET E PUBLIKUT
 LEJET MJEDISORE
 DOKUMENTA TE NEVOJSHEM
 TE REJAT E FUNDIT
 GALERIA



Numër i gjelbër
0 800 6666

e-albania



search...

Zona te Mbrojtura te Shqiperise
 Parqet Kombetare te Shqiperise

FOTOGRAFOHET NË VENDIN TONË RREQEBULLI I BALLKANIT

THURSDAY, 12 Maj 2011 10:00

Një ekip kërkimor i Shoqatës për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), pas një pune të gjatë e plotë pasion, ka fotografuar në terren, pas shumë dekadash, në gjendje të egër, në rajonin malor të Shqipërisë veriore Rrëqebullin e Ballkanit (*Lynx lynx martinoi*). Ky fotografim u bë i mundur me anë të përdorimit të kamerave-kurth, më 26 Mars 2011, në orën 18:48.

Rrëqebulli i Ballkanit është një nga llojet e faunës më të rrezikuar në Shqipëri dhe që prej vitit 2006, PPNEA së bashku me partnerë ndërkombëtare nga Zvicra, Gjermania, Maqedonia dhe Norvegjia, ka ndërmarrë një program për studimin dhe ruajtjen e popullatës së tij (Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit- www.catsg.org/balkanlynx). Vlerësimet më të fundit të ekspertëve tregojnë se numri i Rrëqebujve në Shqipëri nuk i kalon 15-20 individë në total dhe si i tillë është klasifikuar lloji i kërcënuar në mënyrë kritike (CR-Lista e Kuqe, 2007).

Gjithsesi, nga kërkimet ndër vite me metoda bashkëkohore shkencore, deri më sot nuk ishte provuar prania e Rrëqebullit në gjendje të egër në Shqipëri dhe shenjat e prezencës së tij vinin kryesisht nga individë të vvarë dhe të ruajtur si trofe ose nga informacione rastësishme të marra nga popullsia e zonave rurale. Rrëqebulli është lloj plotësisht i mbrojtur dhe gjuetia e tij ndalohej rreptësisht bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Faunës së Egër (Nr. 10 006/2008) dhe Ligjit për Gjuetinë (Nr. 10 253/2010). Rrëqebulli ka patu mbrojtje të plotë ligjore në vend që prej vitit 1969.

Rrëqebulli mbrohet edhe nga konventa ndërkombëtare, si Konventa e Bernës dhe Konventa Ndërkombëtare për Tregtinë e Shtetit në Rrezik (CITES), të cilat janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Situata e Rrëqebullit të Ballkanit është edhe më alarmante mendohet se ai përbën një popullatë dhe nënloj (subspecie) më vete dhe të diferencuar gjenetikisht nga popullatat e rrëqebullit tjerë nëpër botë. Ky fotografim është një nga rezultatet më të rëndësishme të arritura deri më tani, pasi provon në mënyrë direkte praninë e Rrëqebullit në vendin tonë dhe përbën një thirrje të fuqishme për marrjen e masave të menjëhershme për ruajtje dhe të habitateve ku ata jetojnë. Kësaj, ai ka vlera të mëdha për diversitetin biologjik dhe trashëgiminë natyrore të vendit të përbën një thesar të natyrës shqiptare.

